



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/ 16, 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe neni 16, paragrafi (18) nga Ligji i Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 90/22), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM

për shumën minimale të policës së sigurimit ose garancisë së mbulimit të detyrimit

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhen kriteret e:
 - përcaktimit të shumës minimale të policës së sigurimit për sigurimin e përgjegjësisë profesionale ose të garancisë së mbulimit të detyrimeve pa kundërshtime dhe e pagueshme në thirrjen e parë që do të ofrohet nga institucionet pagesore për ofrimin e shërbimeve për inicimin e pagesave dhe shërbimet për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore, në pajtim me Ligjin e Shërbimeve Pagesore dhe Sistemeve Pagesore (në tekstin e mëtejme: shuma minimale e policës së sigurimit ose garancisë) dhe
 - kushteve që duhet të plotësojnë institucionet financiare që lëshojnë policat ose garancitë nga paragrafi (1) i kësaj pike.

II. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË SHUMËS MINIMALE TË POLICËS SIGURIMORE APO GARANCISË TË MBULIMIT TË DETYRIMIT

2. Për nevojat e përcaktimit të shumës minimale të policës së sigurimit ose garancisë, përdoren kriteret e mëposhtme që lidhen me funksionimin e institucionit pagesor:

- profili i rrezikut të institucionit pagesor;
- vëllimi i aktiviteteve të institucionit pagesor.

3. Shuma minimale e policës së sigurimit ose garancisë paraqet përmbledhje të:

- shumës e cila lidhet me profilin e rrezikut të institucionit pagesor, të përcaktuar në pajtueshmëri me pikën 5) të këtij vendimi dhe
- shumës që lidhet me vëllimin e veprimtarive të institucionit pagesor, të përcaktuar në pajtim me pikën 8) për institucionet që ofrojnë shërbime për fillimin e pagesave dhe/ose pikën 9) për institucionet që ofrojnë shërbime për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore nga ky vendim.

Institucioni pagesor është i detyruar të përcaktojë shumën minimale të policës së sigurimit ose garancisë nga paragrafi (1) i këtij vendimi, në bazë vjetore të të dhënave të vitit kalendarik paraardhës, por jo më vonë se data 30 qershor.

Institucioni pagesor është i detyruar të njoftojë Bankën Popullore për shumën minimale të përcaktuar të policës së sigurimit ose garancisë, në afat jo më vonë se 30 ditë pas datës së përcaktimit nga paragrafi (2) i kësaj pike.

Shuma e policës së sigurimit ose garancisë me rastin e paraqitjes së kërkesës për marrjen e lejes për ofrimin e shërbimeve pagesore për iniciimin e pagesave dhe shërbimeve për dhënien e informatave për llogaritë pagesore është 9.000.000 denarë.

4. Nëse institucioni pagesor ofron edhe shërbime për iniciimin e pagesave dhe shërbimeve për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore, shuma minimale e policës së sigurimit ose garancisë nga pika 3) e këtij vendimi përcaktohet për të dy llojet e shërbimeve individualisht dhe me rastin e përcaktimit të shumës së policës ose garancisë merret shuma totale e tyre.

II.1 Profili i rrezikut të institucionit pagesor

5. Shuma e lidhur me profilin e rrezikut të institucionit pagesor përfaqëson shumën e vlerës së kërkesave për pagesën e dëmeve, e përcaktuar në pajtim me pikën 6) të këtij vendimi dhe vlerën e treguesit për numrin e pagesave të iniciuara, ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit të llogarive pagesore të institucionit pagesor, të llogaritura në pajtim me pikën 7 të këtij vendimi.

6. Vlera e kërkesave për pagesën e dëmit paraqet shumën totale të të gjitha kërkesave për pagesë të dëmeve të marra nga përdoruesit e shërbimeve pagesore të institucionit pagesor, gjatë 12 muajve të mëparshëm.

Nëse institucioni pagesor ofron shërbime pagesash për më pak se 12 muaj, vlera nga paragrafi (1) i kësaj pike është së paku 3.000.000 denarë.

7. Vlera e treguesit të numrin të pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në institucionin pagesor llogaritet si shumë e elementëve të mëposhtëm, si në vijim:

- 40% e numrit të pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në institucionin pagesor në 12 muajt e mëparshëm shumëzuar me 60, nëse ky numër është i barabartë ose më i vogël se 10.000 dhe shtohet edhe më tej,
- 25% e numrit të pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në institucionin pagesor në 12 muajt e mëparshëm, nëse numri kalon 10.000 deri në 100.000 shumëzuar me 60 dhe shtohet edhe më tej,
- 10% e numrit të pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në institucionin pagesor në 12 muajt e mëparshëm, nëse numri kalon 10.000 deri në 100.000 shumëzuar me 60 dhe shtohet edhe më tej,
- 5% e numrit të pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në institucionin pagesor në 12 muajt e mëparshëm shumëzuar me 60, nëse ky numër është i barabartë ose më i vogël se 60 dhe shtohet edhe më tej,
- 0,025% e numrit të pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në institucionin pagesor në 12 muajt e mëparshëm mbi 10.000.000 shumëzuar me 60.

Nëse institucioni pagesor ofron shërbime pagesore për më pak se 12 muajt, vlera nga paragrafi (1) i kësaj pike është së paku 3.000.000 denarë.

II.2 Vëllimi i aktiviteteve të institucionit pagesor

8. Shuma e lidhur me vëllimin e aktiviteteve të institucionit pagesor që ofron shërbime të inicimit të pagesave llogaritet si shumë e elementeve të mëposhtëm, si në vijim:

- 40% nga vlera totale e pagesave të iniciuara në 12 muajt e mëparshëm, nëse kjo vlerë është e barabartë ose më e vogël se 31.000.000 denarë dhe shtohet edhe më tej,
- 25% e numrit të pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në 12 muajt e mëparshëm, nëse vlera kalon mbi 31.000 deri në 62.000.000 denarë dhe shtohet edhe më tej,
- 10% e vlerës së pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në 12 muajt e mëparshëm nëse numri kalon 62.000.000 deri në 310.000.000 denarë dhe shtohet edhe më tej,
- 5% e vlerës së pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në 12 muajt e mëparshëm nëse numri kalon mbi 310.000.000 deri në 620.000.000 denarë dhe shtohet edhe më tej,
- 0,025% e vlerës së pagesave të iniciuara ose shërbimeve të ofruara për dhënien e informacionit për llogaritë pagesore në 12 muajt e mëparshëm nëse vlera është mbi 620.000.000 denarë.

9. Shuma e lidhur me vëllimin e aktiviteteve të institucionit pagesor që ofron shërbime të inicimit të pagesave llogaritet si shumë e elementeve të mëposhtëm, si në vijim:

- 40% e numrit të klientëve që përdorin shërbime për të marrë informacione rreth llogarive pagesore nga institucioni pagesor në 12 muajt e mëparshëm, shumëzuar me 60, nëse ky numër është i barabartë ose më i vogël se 100 klientë dhe shtohet edhe më tej,
- 25% e numrit të përdoruesve/klientëve që përdorin shërbime për të marrë informacione rreth llogarive pagesore nga institucioni pagesor në 12 muajt e mëparshëm, nëse ky numër është mbi 100 deri në 10.000 klientë shumëzuar me 60 dhe shtohet edhe më tej,
- 10% e numrit të përdoruesve/klientëve që përdorin shërbime për të marrë informacione rreth llogarive pagesore nga institucioni pagesor në 12 muajt e mëparshëm, nëse ky numër është mbi 10.000 deri në 100.000 klientë shumëzuar me 60 dhe shtohet edhe më tej,
- 5% e numrit të përdoruesve/klientëve që përdorin shërbime për të marrë informacione rreth llogarive pagesore nga institucioni pagesor në 12 muajt e mëparshëm, nëse ky numër është mbi 100.000 deri në 1.000.000 klientë shumëzuar me 60 dhe shtohet edhe më tej,
- 25% e numrit të përdoruesve/klientëve që përdorin shërbime për të marrë informacione rreth llogarive pagesore nga institucioni pagesor në 12 muajt e mëparshëm, nëse ky numër është mbi 1 milion klientë shumëzuar me 60.

Nëse institucioni pagesor ofron shërbime pagesore për më pak se 12 muaj, vlera nga pikat 8) dhe 9) e këtij vendimi është së paku 3.000.000 denarë.

III. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË INSTITUCIONET FINANCIARE QË LËSHOJNË POLICAT OSE GARANCI

10. Institucioni financiar që lëshon garancinë e mbulimit të detyrimit pa kundërshtim dhe i pagueshëm në thirrjen e parë si siguri e detyrimeve ndaj ofruesit të shërbimeve pagesore mund të jetë bankë me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose bankë e huaj, vlerësimi më i fundit i kredisë afatgjatë i së cilës është të paktën AA-(sipas vlerësimit të "Standard & Pours" ose "Fiç") ose në Aa3 (sipas vlerësimit të Mudis).

11. Institucioni financiar që lëshon policë sigurimi si garanci për detyrimet ndaj ofruesit të shërbimit pagesor mund të jetë kompani sigurimesh me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut ose kompani e huaj sigurimesh, vlerësimi i fundit afatgjatë i kreditit të së cilës është së paku i barabartë me AA- (sipas në vlerësimin "Standard and Pours" ose "Fiç") ose në Aa3 (sipas vlerësimit të Mudis).

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

12. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë të publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe do të zbatohet nga 1 janari 2023.

V. nr. 02-15/XX-4/2022
25 nëntor, 2022
Shkup

Guvernatorja
dhe Kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
д-р Анита Ангеловска-Бежоска